



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.527/21

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Arbnor Tahiri duke vendosur përkitazi me apelin e Sadri Krasniqi për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET apeli A.nr.527/2021, i Sadri Krasniqi, paraqitur kundër KQZ për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës, për arsye se parashtruesit të apelit i mungon interesi juridik.

A r s y e t i m

Me datë 23.08.2021, parashtruesi i apelit Sadri Krasniqi, ka parashtruar ankesë kundër KQZ për shkak të mos përfshirjes lista përfundimtare e votuesve, me pretendimin se i njëjti edhe pse kishte aplikuar për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës nuk e ka gjetur emrin e tij në listë.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht apelin, gjeti se:

Parashtruesit të Apelit i mungon interesi juridik

Me datë: 23.08.2021 Sadri Krasniqi, ka parashtruar në PZAP ankese ndaj vendimit për miratim të listës përfundimtare të votuesve. PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit gjendet në listën e votuesve meqenëse i njëjti i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë.

PZAP duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse i njëjti është i përfshirë në listën e votuesve.

Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është pa interes juridik pasi Sadri Krasniqi, gjendet në listën votuese.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.527/21 më datën 25.08.2021.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.